



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 01 .

Prishtinë, më 26.12.2014 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Milosavljević, Agim Ceku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Blerim Shala, Milka Vuletic, Slavko Simić, Jasmina Živkovic, Čerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësues nga OSB-ja Adriana Gashi, përfaqësuesit Ambasada Zvicerane, përfaqësues nga Presidenca e Kosovës, Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Milosavljević, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Mbledhja Konstituive ;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me raport amandamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryesuesi –me theks të veçantë tha se ndihet i privilegjuar që do të kryeson Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe përshëndet për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit. Gjatë mandatit, do të kontribuon për çështjet e ngritura, sa i përket mbrojtjes dhe interesave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Kryesuesi- për prezantim fjalën iu dha anëtarëve tjerë të komisionit.

Agim Çeku – tha se është nënkryetari i parë i komisionit për Komunitete dhe vjen nga GP i PD-së. Ishte i mendimit që në këtë përbërje komisioni do të jetë konstruktiv në funksionalizimin dhe realizimit e detyrave që bartë ky komision.

Slavko Simic- anëtar i Listës serbe, shprehu qëndrimin e tij se si deputet i ri në Parlamentin e Kosovës, do të jap kontribut të duhur dhe njëherit pret të gjej përkrahje dhe udhëzime të drejta.

Jasmina Zivkovic – anëtare e Listës serbe, Ajo tha se vet titulli i Komisionit na udhëzon që të mbrohen të drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Shpreh vullnetin e saj që të ketë përkrahje jo vetëm nga komuniteti ynë por edhe nga komuniteti shumicë dhe ai jo shumicë.

Milka Vuletic – anëtare e LS- të gjithë jemi të vetëdijshëm për rendësin që ka komisioni dhe shprehu vullnetin të ketë bashkëpunim të mirë ku nuk do të mungoj as suksesi.

Danush Ademi – përfaqësues i GP 6 + përshëndet anëtarët e komisionit duke shprehur mendimin se do të kontribuojë për një mirëqenie të mirëfilltë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë

Agim Kikaj – anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ai shprehu gatishmëri në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi që ka Komisioni, në mënyrë që angazhimet dhe puna jonë të dal me sukses të duhur.

Fisnik Ismaili – anëtar i GP Vetëvendosje, për herë të parë deputet në Kuvendin e Kosovës. Ai i dëshiron mbarëvajtje Komisionit dhe shprehu qëndrimin e tij se do të ofroj përkrahje në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Mufera Sinik – anëtare e GP 6 + , shprehu vullnetin e saj të ketë bashkëpunim të mirë dhe se do të ofrojë kontribut në mbrojtjen e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Shtoi se komunitetet janë çështje njerëzore dhe në këtë drejtim do të ofrojmë maksimumin në shqyrtimin e të gjitha çështjeve të cilat do ta ndihmojë atë në nivel Parlamentar.

Veton Berisha –përfaqësues i GP të LDK , theksoi se ndjehet shumë mirë që është anëtar në këtë komisioni. Gjatë mandatit do të jap kontribut maksimal për ngritjen e çështjeve të komunitetit të tij.

Qerim Bajrami- përfaqësues i GP 6 +, tha se në legjislaturën e kaluar ka qen zëvendës ministër i Ministrisë së Diasporës, e njeh natyrën e punës andaj do të kontribuojë për një mirëqenie të mirëfilltë për të gjitha komunitetet.

Kryesuesi – me theks të veçantë tha se për ditën e sotme nuk do të shqyrtohet pika tret e rendit të ditës, të bazuar në mbështetje të nenit 6.5(5) së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 56 dhe 84 të Rregullores së Kuvendit, me qëllim të procedurave të përshpejtuara për shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2015. Me arsye se në seancë plenare të datës 22 dhjetor 2014, Kuvendi ka dalë me Vendim: Komisioni për Buxhet dhe financa shqyrton Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia paraqet Raportin me rekomandime.

Lidhur me këtë propozim, vërejtje kishin Mufera Sinik, Danush Ademi, nga se me Projektligjin e buxhetin të Republikës së Kosovës për vitin 2015, nuk është përfshi Kodi i veçantë për komunitetin jo shumicë.

Agim Çeku - bazuar në Rregulloren e Kuvendit, gjatë shqyrtimit të Projektbuxhetit secili deputet ka të drejtë të marr pjesë në mbledhje të komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të ofroj propozimet e tyre konkrete.

Kryesuesi – Konsideron se duhet ti përmbahemi vendimeve të marra nga Kryesia e Kuvendit ishte i mendimit se për sot do të shqyrtohen vetëm dy pikatë rendit të ditës duke dhënë sqarim se propozimet eventuale është dashur me kohë të dërgohen në Komision për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi— konstatoi se rendi i ditës u miratua, me ndryshimin e theksuar më lartë.

2. Mbledhja Konstituive

Kryesuesi - shpalosi në detaje fushë veprimtarinë dhe kompetencat e komisionit, të bazuara në Kushtetutë, Rregullore të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës. Komision, në pjesën e fushëveprimit të vet, do të monitorojë edhe zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Komisioni, veprimtarinë do ta ushtrojë duke u mbështetur në Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2015. Më pas komisioni do të formojë grupin punues në hartimin e Planit të punës periodike, për vitin 2015.

Anëtarët e komisionit njëzëri deklaruan se në komision do të ketë frymë të mirë bashkëpunimi, në mënyrë që angazhimet dhe puna e komisionit të dalë me sukses.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sasa Milosavljevic